



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:030452
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05544943

C.nr.11/2024

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari G. A, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. M. nga fshati K, Komuna e N. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K. A- S avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e N, me objekt kontesti: kompensimi i diferences së pagës sipas inflacionit, jashtë seancës, me datë 03.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

P a s h q y r t i m k r y e s o r t ë q ë s h t j e s

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E. M nga fshati K, Komuna e N. dhe **DETYROHET** e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e N., që paditëses t'ia paguajë në emër të pagesës së inflacionit për periudhen kohore nga data 01.11.2021deri me 31.01.2023, për 15 muaj, shumën prej 1,549.95€, me kamatë ligjore prej 8% nga data 25.01.2024, datë e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi, nën pasoja të përmbarimit të detyrueshëm.

II.Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi , përmes të autorizuarës së tij me datën 25.01.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e me objekt kontesti, kompensimi i diferences së pagës sipas inflacionit. Në përmbajtjen e padisë i njëjti ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës me kualifikim shkollor me diplom master i arteve në kultur fizike dhe sport, në Shkollën e Mesme Ekonomike P.N.F, në fshatin Ll K. në N, si mësimdhënës në lëmin e ekonomis, nga data 03.11.2014, dhe asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura për kompensimi i diferences së pagës sipas inflacionit nga data 01.11.2021 deri më 31.01.2023, andaj ka kërkuar që paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,549.95euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksën gjyqësore dhe për përpilimin e padisë, gjithsej shumën e përgjithshme prej 124.00€.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 22.02.2024, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që ka konsideruar, se nuk ka bazë ligjore për pagesën e diferencës në pagë për periudhën nga 01.11.2021 deri më 31.01.2023. Më tej, ka theksuar se paditësja është e punësuar te e paditura në shkollën e Mesme Ekonomike në Novobërdë. Që ga themelimi i saj e paditura ende nuk i ka paguar snjërit nga punëtoret diferencën në pagë. Po ashtu ka shtuar se Kontrata e Përgjithshme Kolektive në Kosovë nga viti 2017 dhe 2021, nuk paraqet bazë ligjore për arsye se ekziston njoftimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit nr.OIB/488 nga 21 nëntor 2022, për shkëputjen e kontratës Kolektive të datës 20 Janar 2021, ashtu që kjo padi duhet të refuzohet si e pabazuar në ligj.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi të datës 14.06.2023, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera, për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjegja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është e themeltë.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, në këtë çështje kontestuese i ka administruar këto prova materiale:

Nga leximi i Kontratës së Punës për mësimdhënës e dt.01.09.2020, u vërtetua se paditësi ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e Novobërdës-DKA më dt.01.09.2020, për kohë të pacaktuar, ku i njëjti sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënës në SHM. Ekonomike dhe P.N.F Skenderbeu, Makresh, dhe në fshatin Bostan K. Novobërdë. Paga neto 413.95 dhe fondi i orëve 18.

Nga leximi i Vërtetimit të dt.04.12.2023 i lëshuar nga SHM Ekonomike në fsh. Ll, me të cilën vërtetohet se paditësi nga data 03.11.2014, ka filluar të punoj dhe se vazhdon të punoj .

Nga Lista e pagave për muajin Dhjetor 2021, u vërtetua fakti se paditësi E. M. ka pagën neto 433.58 €, përvoj pune 7 vjet, ndërsa për shkak të gradimit realizon shumën mujore në lartësi prej 57.32€.

Nga leximi i indeksit të harmonizuar të qmimeve të konsumit lëshuar nga Qeveria e Republikës-Agjensia e Statistikave të Kosovës, u vërtetua fakti se indeksi i harmonizuar i qmimeve të konsumit për vitin 2021 është në inflacionin vjetor 3.40%, ndërsa në vitin 2022 në inflacionin vjetor është në 11.60%.

Nga leximi i Diplomes me nr. 078/21, të Kolegjit AAB, e datës 23.01.2021, u vërtetua fakti se, paditësi është mësimdhënës me diplomë, që nga data 23.01.2021, me titullin Master i Arteve në Kultur Fizike dhe Sport.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e

shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ *kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontrata e Kolektive e Arsimit në Kosovë e vitit 21.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 5, 7, 8 dhe 10 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Kërkesa e paditëses për shpërblimin e inflacionit në pagë, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ *Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.*”, e në rastin konkrete gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar -dhjetor 2021, mesataren vjetore prej 3.4% dhe për periudhën Janar-Nëntor 2022 dhe ate deri më datën 21.11.2022 (ngase kjo kontratë është shkëputur nga Qeveria e Republikës së Kosovës me këtë datë) mesataren vjetore prej 11.6%, të gjitha këto në vlerë të pagës bazë prej 459.00€, andaj gjykata e ka obliguar të paditurën, që paditëses t’ia kompensoj shumën prej 1,549.95€, sipas mesatares vjetore të lartcekur.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t’i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Sa i përket pretendimit të palës së paditur se kërkesa e paditësit duhet të refuzohet për shkak të se kjo kontratë është shkëputur më datën 21.11.2022, për gjykatën një pretendim i tillë është i pabazuar ngase e njëjta padinë e ka paraqitur në afatin e paraparë ligjore, që do të thotë se padinë e ka paraqitur pas arritjes së kërkesave për pagesë, përkatësisht për periudhën kohore nga data (01.11.2021 deri më 31.01.2023, për 15 muaj), ku vërtetohet me vërtetimin e lëshuar nga e paditura me datën 04.12.2023, se paditësi është në mardhënie pune tek e paditura dhe ate nga data 04.12.2023. Ku edhe ka pervoj pune prej 7 vite.

Kërkespacia e paditësit gjen mbështetje edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. GJ.A-Su.A 214/2023 të datës 09.10.2023, respektivisht në pikën II të dispozitivit të këtij mendimi.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. e datës 21.01.2021*, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 datë 19.06.2012.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104€ dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 €, e në shumën e përgjithshme prej 124€.

Duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan –Dega Novobërdë
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.11/2024, më datë 03.04.2024**

**Gjyqtari,
G. A.**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:030452
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05544943